



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**U R D H Ë R**

Nr. 194 Datë 27 10. 2011

**“PËR SHËRBIMIN E GATISHMËRISË NË PROKURORI”**

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 shkronja “gj”, nenit 49 dhe të nenit 52 të ligjit Nr. 8737, datë 12. 02. 2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë ” (i ndryshuar),

**U R D H Ë R O J:**

**KREU I  
SHPJEGIMI I TERMAVE**

**Neni 1**

“Shërbimi i Gatishmërisë” në sistemin e prokurorisë kuptohet mbajtja në gjendje të tillë e burimeve njerëzore (prokurorit dhe strukturave ndihmëse) dhe infrastrukturës, për të bërë të mundur zgjidhjen në kohë të problematikave të ngutshme të ndjekjes penale, brenda apo jashtë orarit zyrtar të punës.

“Detyrë e ngutshme” do të konsiderohet çdo detyrë që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale e asaj natyre, zgjidhja e së cilës nuk mund të presë ditën pasardhëse të punës.

**KREU II  
PARIMET E ORGANIZIMIT DHE PAGESËS**

**Neni 2**

1. Në organizimin e gatishmërisë mbahet gjithmonë parasysh fleksibiliteti në administrimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës.
2. Në realizimin e gatishmërisë të mbahet parasysh që përdorimi i burimeve njerëzore apo infrastrukturës të jetë në përputhje me nevojat për realizimin e detyrimeve të ngutshme.
3. Gatishmëria jashtë orarit zyrtar, realizohet jo domosdoshmërisht duke qëndruar në ambjentet e punës.
4. Prokurori i gatshëm, si rregull, është prokurori që do të zgjidhë deri në fund rastin e paraqitur gjatë kohës së gatishmërisë.

5. Pagesa për qëndrimin në gatishmëri tej orarit zyrtar apo në ditë pushimi është e ndryshme nga pagesa për punë të kryer gjatë gatishmërisë dhe në përputhje me parashikimet e nenit 8 të këtij urdhri.

### **KREU III ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GATISHMËRISË**

#### **Neni 3**

1. Drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë dhe drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, merr të gjitha masat për organizimin e gatishmërisë në prokurorinë që drejton në përputhje me këtë urdhër.
2. Pas analizës dhe studimit mbi burimet në dispozicion, ato të nevojshme për të përballuar gatishmërinë dhe në përputhje me orientimet e këtij urdhri, drejtuesi i prokurorisë nxjerr urdhrin e brendshëm për organizimin e gatishmërisë, i cili hyn në fuqi pas miratimit nga Prokurori i Përgjithshëm.
3. Drejtuesi i prokurorisë harton grafikun e shërbimit të gatishmërisë dhe ndjek zbatimin me korrektesë të tij.

Në prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Fier, Shkodër, Elbasan dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, të planifikohen në shërbimin e gatishmërisë edhe niveli drejtues i prokurorisë.

4. Prokurori i caktuar për gatishmëri (*ku në prokuroritë e rretheve gjyqësore që kanë në strukturë jo më shumë se 6 prokurorë mund të planifikohet dhe vetë drejtuesit si prokurorë të gatshëm*) organizon punën në mënyrë të tillë që aktiviteti i zakonshëm i tij të mos bëhet pengesë për ndjekjen e problematikës që mund të dalë gjatë këtij shërbimi. Ky organizim lidhet si përsa i përket aktivitetit në përfaqësimin e çështjeve në gjykatë ashtu dhe në organizimin e aktivitetit të ndjekjes penale gjatë hetimeve.
5. Gjatë periudhës së gatishmërisë, prokurori përveç detyrave të tjera të ngutshme:

4.1.1. Merr dijeni për veprat penale të ndodhura, me iniciativën e vet dhe me njoftimet e bëra nga të tjerët, duke mbajtur lidhje me shërbimet e policisë gjyqësore;

4.1.2. Është i pranishëm në vendngjarje për veprat penale që me akte të tjera është parashikuar detyrimi i pjesëmarrjes apo kur çmon se për shkak të natyrës së ngjarjes pjesëmarrja është e domosdoshme;

4.1.3. Merr njoftime për arrestime në flagrancë dhe ndalime, merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarit dhe kontrollon ligjshmërinë e tyre, merr pjesë në veprime të caktuara, autorizon përgjime, sekuestrime etj, si dhe pasi i diskuton me drejtuesit, u jep zgjidhje ligjore problemeve të ngutëshme brenda kompetencave në ushtrimin e funksioneve të tij, sipas përkatësisë procedurale.

4.1.4. Njofton menjëherë drejtuesit e prokurorisë për ngjarje dhe/ose vepra kriminale të rënda të ndodhura në juridiksionin e tyre, i cili vlerëson jo vetëm prezencën e tij por dhe nëse për të duhen njoftuar strukturat eprore;



4.1.5. Çdo prokurori identifikon një numër fiks dhe një numër celulari si numra të shërbimit të gatishmërisë. Këto numra bëhen publikë dhe u njoftohen veçanërisht strukturave policore.

#### **KREU IV GATISHMËRIA GJATË ORARIT ZYRTAR**

##### **Neni 5**

1. Gjatë orarit zyrtar, aktiviteti i prokurorit është zgjidhja e detyrave të ngutshme që lidhen me ndjekjen penale.
2. Përveç sa më sipër, ai vetë apo nëpërmjet strukturave ndihmëse ka për detyrë të marë dhe kallëzimet me gojë që subjekte të ndryshëm mund të bëjnë drejtpërdrejt në prokurori.

#### **KREU V GATISHMËRIA NË DITËT E JAVËS, DITËT E FUNDIT TË JAVËS DHE NË DITËT E FESTAVE ZYRTARE**

##### **Neni 6**

1. Pas orarit zyrtar, prokurori apo një nga drejtuesit të planifikuar në shërbimin e gatishmërisë, duhet të garantojnë disponueshmërinë e tyre në çdo kohë për zgjidhjen e detyrave të ngutshme.
2. Prokurori apo një nga drejtuesit të planifikuar në shërbimin e gatishmërisë është i detyruar të qëndrojë në një hapësirë të tillë larg institucionit, që do t'i bënte të mundur paraqitjen pranë institucionit, brenda 30 minutave.
3. Gjatë kësaj kohe, ai qëndron në komunikim me të gjithë personat e përfshirë në shërbim, si dhe duhet të jetë i arritshëm në çdo moment nga strukturat policore.
4. Me marrjen njoftim në lidhje me detyrën e ngutshme, prokurori paraqitet në institucion apo në vendin ku është e nevojshme prania e tij, për realizimin e detyrës.
5. Ai organizon të gjitha strukturat përkatëse në funksion të zgjidhjes sa më të mirë të detyrës.
6. Në prokuroritë e rretheve, të cilat për shkak të ngarkesës së vogël planifikohet vetëm një prokuror i gatshëm dhe në trajtimin në dinamikë të rastit (*siç mund të jenë ato që lidhen me procesin e vendimmarrjes për ndalimet apo arrestimet, lirimet e menjëhershme, masat e sigurimit, veprime të tjera urgjente që kërkojnë konsultime, pjesëmarrja apo asistimi në kryerjen e veprimeve të caktuara, përgjimet, komunikimin shkresor me organe të tjera si me policinë, burgjet apo gjykatat etj*) kërkohet domosdoshmërisht prania e drejtuesit, ky i fundit merr masat për të garantuar prezencën e tij.

**KREU VI**  
**SHPËRNDARJA E ÇËSHTJEVE TË REGJISTRUARA GJATË KOHËS SË**  
**GATISHMËRISË**

**Neni 7**

1. Si rregull, çështjet, procedimet, kallëzimet për të cilat prokurori ka ardhur në dijeni gjatë kohës së shërbimit të gatishmërisë do të ndiqen prej tij.
2. Në raste të veçanta, me kërkesë tij apo vendim të arsyetuar të drejtuesit, prokurori mund të zëvendësohet në ndjekjen e një çështjeje të caktuar.

**KREU VII**  
**PAGESA**

**Neni 8**

1. Për qëndrimin në gatishmëri pas orarit zyrtar, prokurorët paguhen sipas parashikimeve të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).
2. Prokurori i gatshëm, në ditët e zakonshme të punës, për cdo orë shtesë tej orarit zyrtar paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtesë të kësaj page.
3. Në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, prokurori i gatshëm ose prokurori që kryen detyra të ngutshme në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër, Vlorë dhe në Prokurorinë për Krime të Rënda, qëndron në zyrë. Ai përfiton shtesë page, në masën 50 për qind të pagës së tij ditore.
4. Në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, prokurori i gatshëm ose prokurori që kryen detyra të ngutshme në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Berat, Dibër, Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Lushnje, Lezhë, Mat, Pukë, Pogradec, Sarandë, Tropojë Kavajë, Kurbin dhe Përmet, përfiton shtesë page, në masën 50 për qind të pagës së tij ditore vetëm kur ka ngjarje ose kryen detyra të ngutshme.
5. Në rastet e paraqitjes së detyrës së ngutshme pas orarit zyrtar, apo nëse zgjidhja e detyrës së ngutshme kërkon praninë e tij
6. pas këtij orari, në ditët e pushimit apo të festave zyrtare, prokurori apo ndonjë nga drejtuesit e gatshëm hartojnë një raport përmbledhës në lidhje me të, kohën e marrjes së saj si dhe kohën e shpenzuar për zgjidhjen. Ky raport i paraqiten drejtuesit të prokurorisë, e më pas zyrës ekonomike për të bërë pagesën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**KREU VIII**  
**DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI**

**Neni 9**

1. Me këtë urdhër të njihen prokurorët e të gjithë niveleve të Prokurorive dhe personat e tjerë që ngarkohen për zbatimin e tij.

2. Për të ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen drejtuesit e Prokurorive të shkallës së parë, si dhe drejtuesit dhe Sekretari i Përgjithshëm pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Moszbatimi i kërkesave të këtij urdhëri, përbën shkelje të disiplinës në punë.

#### **Neni 10**

1. Urdhëri nr. 169 datë 29.08.2002 “Për gatishmërinë dhe informimin në Prokurori” dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të tij, shfuqizohen.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**



**INA RAMA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORI I PËRGGJITHSHËM**

**URDHËR**

Nr. 191/1 / Datë 03.11.2011

**“PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 191, DATË 27.10.2011 “PËR  
SHËRBIMIN E GATISHMËRISË NË PROKURORI”**

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 shkronja “gj”, nenit 49 dhe të nenit 52 të ligjit Nr. 8737, datë 12. 02. 2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë ” (i ndryshuar),

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr. 191, datë 27.10.2011 “Për shërbimin e gatishmërisë në Prokurori”, bëhet një shtesë me përmbajtjen si më poshtë:

**Neni 1**

“1. Në paragrafin 3, të nenit 8 të kreut të VII-të “PAGESA”, pas fjalës “...Elbasan”, shtohet fjala “Fier””.

**Neni 2**

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGGJITHSHËM**

**INA RAMA**

Drejtoria e Praktikës

03 NOV 2011

ZYRA E PROTOKOLLIT